

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NAZI” SH.P.K.**

Në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe akteve nënligjore përkatëse, u hartua ky akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “NAZI” sh.p.k., me të dhënat si më poshtë:

Neni 1 – Data e themelimit, emri dhe forma juridike

Sot, më datë 25.08.2025, themeluesi vendos krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Shoqëria do të mbajë emrin “NAZI” sh.p.k.

Shoqëria do të jetë një person juridik shqiptar, me përgjegjësi të kufizuar, që fiton personalitet juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2 – Themeluesi

Themelues dhe njëkohësisht ortak i vetëm i shoqërisë është:

Nazmi Lami, shtetas shqiptar, i datëlindjes 23.10.1983, me NID (Numër Identifikimi Personal): I31028080B, banues në Rruga Europa, Kamëz, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 – Selia

Selia ligjore e shoqërisë ndodhet në: Rruga Azem Galica, godinë 1-kat, ZK 2066, Vol. 54, Fq. 149, Nr. Pasurie 74/95, Kamëz, Tiranë, Shqipëri.

Adresa elektronike e shoqërisë për qëllime komunikimi është: info.nazishpk@gmail.com.

Numri i kontaktit do të jete: +355686222001

Neni 4 – Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë këto aktivitete:

- Gërmime dhe sistemime dheu, punime, tarracime terrenesh, murature dhe beton arme.
- Prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Prodhim elementesh betoni e betonarme të zakonshme dhe të parapërgatitura.
- Ndërtim godinash deri në 5 kate; ndërtim rrugësh të kategorisë I, II, III, IV dhe V; punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit rrugor.
- Ndërtim mbishtresash rrugore, punime hekurudhore, sisteme elektrike dhe sinjalizimi, ura dhe vepra arti mbi dhe nën 10 metra.



- Ndërtim ujësjellës-kanalizime, kanale dhe impiante vaditëse, punime mbrojtëse hidraulike, çimentime etj.
- Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të materialeve të ndërtimit; import-eksport të tyre; investime në pasuri të paluajtshme.
- Punime karpenterie, rikonstruksione civile dhe industriale, fasada, konstruksione metalike, montime panelesh, asfaltime, hapje kanalesh, punime elektrike dhe hidraulike.
- Çdo aktivitet tjetër të lidhur me fushën e ndërtimit, në përputhje me ligjin.

Neni 5 – Kohëzgjatja

Shoqëria është e krijuar me afat të pacaktuar.

Neni 6 – Kapitali fillestar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili do depozitohet plotësisht në llogarinë bankare të shoqërisë në momentin e regjistrimit në QKB, I përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë 100. 000 (njëqind mijë) lekë.

Ortaku themelues Nazmi Lami zotëron 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet sipas dispozitave ligjore dhe vendimeve të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Neni 7 – Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga Nazmi Lami, me adresë Rruga Europa, Kamëz, Shqipëri, i cili vepron si administrator i vetëm i shoqërisë, me një mandat fillestar prej 5 vitesh, me të drejtë ripërtëritjeje, duke filluar nga data 25.08.2025.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve, organeve shtetërore dhe çdo autoriteti tjetër ligjor.

Administratori ka të gjitha kompetencat e parashikuara në ligj dhe në statut për menaxhimin dhe përfaqësimin e shoqërisë.

Neni 8 – Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë QKB-së dhe mbyllet më 31 Dhjetor 2025.

Neni 9 – Përfaqësimi dhe kompetencat

Administratori ka të drejtë:

- Të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha veprimet juridike dhe financiare;
- Të lidhë kontrata, të hapë llogari bankare dhe të menaxhojë fondet;
- Të depozitojë çdo ndryshim pranë QKB-së dhe institucioneve të tjera kompetente;



- Të raportojë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të mbajë librat ligjorë sipas rregullave të kontabilitetit.

Neni 10 – Rregullat për shpërndarjen e fitimeve

Fitimet shpërndahen proporcionalisht me përqindjen e kuotave në kapitalin themeltar, pas miratimit të pasqyrave financiare nga Asambleja e Ortakut.

Neni 11 – Likuidimi dhe prishja

Shoqëria mund të shpërbëhet dhe të likuidohet në çdo kohë sipas vendimit të Asamblesë së Ortakut, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901/2008 dhe dispozitave ligjore të tjera përkatëse.

Në rast likuidimi, emërohet një ose disa likuidatorë.

Neni 12 – Dispozita të fundit

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me zbatimin e këtij akti, palët do t'i drejtohen Gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

Për çështje të parashikuara pjesërisht ose jo në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901/2008 dhe legjislacioni përkatës shqiptar.

Ky akt u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua sot, më 25.08.2025, nga themeluesi i vetëm i shoqërisë.

Shoqëria NAZI sh.p.k.

Ortaku I vetëm / Themeluesi

Z. Nazmi Lami

